

## **Informator për pajisje me patentë shofer**

### **1) Dokumentet dhe Procedurat për pajisjen me Patentë shofer të Republikës së Kosovës për herë të parë dhe shtim të kategorive pas dhënies së provimit për shoferë për kategorinë përkatëse.**

Bazë juridike Ligji mbi sigurinë në komunikacion rrugor -Nr/02/L-70 dhe udhëzimi administrativ MPB-Nr. 15/2013-MPB

Kërkesa për pajisje me patentë shofer për herë të parë ose shtim të kategorive bëhet në njësitë rajonale të Ministrisë së Infrastrukturës ku është dhënë provimi për shoferë: ( Prishtinë , Prizren, Mitrovicë, Gjakovë ,Pejë, Ferizaj, Gjilan.

Në këto raste kërkohen këto dokumente:

- Certifikata mbi dhënien e provimit,
- Kopja e letërnjoftimit ose e pasaportës së Republikës së Kosovës me afat vlefshmërie,
- Kopjen e patentë shoferit në rast se ka bërë shtimin e kategorive,
- Fletëpagesa me shumë prej 20 euro,
- Dëshmi në rastin e ndërrimit të të dhënave personale,
- Certifikatën Shëndetësore.

### **2) Për ndërrimin e patentë shoferit të UNMIK-ut me patentë shoferë të Republikës së Kosovës.**

Bazë juridike udhëzimi administrativ Nr. 12/2012-MPB

Kërkesa paraqitet në Qendrat për Pajisje me Dokumente në komunën përkatëse

Në këto raste kërkohen këto dokumente:

- Kopjen e patentë shoferit të UNMIK-ut .
- Prezantimi I Letërnjoftimit të Republikës së Kosovës me afat vlefshmërie.
- Prezantimi I Certifikatës shëndetësore për patentë shoferë për kategoritë profesionale ( A1. A. C1. C1E. C. CE. D1. D1E. D. DE). Ndërsa për qytetarët mbi moshën 65 vjeçare edhe për kategorinë (B,BE).

- Raporti policor i cili nuk mund të jetë me i vjetër se 6 muaj. (Ky dokument kërkohet krahas dokumenteve tjera të lartpërmendura në rast se pala ka humbur Patentë Shoferin e UNMIK-ut).
- Fletëpagesa prej 15 Euro.

**3) Për ndërrimin e patentë shoferit të ish RFJ-së- Brenda Kosovës me patentë shofer të Republikës së Kosovës.**

Bazë juridike udhëzimi administrativ Nr. 12/2012-MPB

Kërkesa paraqitet në Qendrat për Pajisje me Dokumente në komunën përkatëse

Në këto raste kërkohen këto dokumente:

- Kopjen e vërtetuar të patentë shoferit të ish RFJ –së (nëse e posedon aplikanti).
- Kopjen e letërënjoftimit të Republikës së Kosovës me afat vlefshmërie.
- Certifikata shëndetësore për kategoritë profesionale. (A1. A. C1. C1E. C. CE. D1. D1E . D. DE). Ndërsa për qytetarët mbi moshën 65 vjeçare edhe për kategorinë (B, BE).
- Dosja ose kartoni i fotokopjuar në arkivin komunal për patentë shoferin e ish RFJ i nënshkruar nga Zyrtari i ZSHPSH-së.
- Fletëpagesa prej 15 euro.

**04) Për përmirësimin e të dhënave në patentë shoferë të Republikës së Kosovës.**

Bazë juridike udhëzimi administrativ Nr. 12/2012-MPB

Kërkesa paraqitet në Qendrat për Pajisje me Dokumente në komunën përkatëse

Në këto raste kërkohen këto dokumente:

- Kopjen e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës me afat vlefshmërie.
- Kopjen e patentë shoferit të Republikës së Kosovës me gabime.
- Kopjen e dëshmisë nga organi kompetent, varësisht nga natyra e gabimit.
- Fletëpagesa prej 15 euro

( Korrigjimin e patentë shoferit mund ta kërkojnë edhe personat, të cilët kanë bërë ndryshimin e të dhënave personale , ndërrimin e emrit ose mbiemrit në bazë të kopjes së letërnjoftimit të Republikës së Kosovës dhe dokumentit të organit kompetent mbi atë ndryshim.

**5) Për pajisje me patentë shoferë të Republikës së Kosovës pas humbjes vjedhjes ose dëmtimit.**

Bazë juridike udhëzimi administrativ Nr. 12/2012-MPB

Kërkesa paraqitet në Qendrat për Pajisje me Dokumente në komunën përkatëse

Në këto raste kërkohen këto dokumente:

- Raporti policor për humbjen e Patentë Shoferit i cili nuk mund të jetë më i vjetër se 6 muaj.
- Prezanton kopjen e letërnjoftimit ose pasaportës të Republikës së Kosovës me afat vlefshmërie.
- Prezanton patentë shoferin në rastë dëmtimi.
- Fletëpagesa prej 15 euro.

**6) Për vazhdimin e patentë shoferit të Republikës së Kosovës.**

Bazë juridike udhëzimi administrativ Nr. 12/2012-MPB

Kërkesa paraqitet në Qendrat për Pajisje me Dokumente në komunën përkatëse

Në këto raste kërkohen këto dokumente:

- Prezanton patentë shoferin dhe letërnjoftimin e Republikës së Kosovës.
- Prezanton Certifikatën shëndetësore të vlefshme për patentë shoferë për kategoritë profesionale. ( A1. A. C1. C. CE. D1. D. DE), si dhe për të gjithë kandidatët më të vjetër se 65 vite edhe për kategorinë B, BE.
- Raporti policor i cili nuk mund të jetë më i vjetër se 6 muaj.  
(Ky dokument kërkohet në rast se pala katë humbur Patentë Shoferin e RKS-ut me afat të skaduar).
- Fletëpagesa prej 15 euro

**Për ndërrimin e patentë shoferit të lëshuar nga shtetet e Huaja anëtare të BE-së me patentë shoferë të Republikës së Kosovës.**

Bazë juridike udhëzimi administrativ Nr. 11/2013-MPB si dhe Ligji mbi sigurinë në komunikacioni rrugor Nr/02/L-70

Kërkesa paraqitet në Qendrat për Pajisje me Dokumente në komunën përkatëse

Në këto raste kërkohen këto dokumente:

- Përkthimi i patentë shoferit të huaj në njërën nga gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës nga përkthyesi i autorizuar; .

- Për shtetasit e Republikës së Kosovës dorëzohet kopja e letërnjoftimit ose e pasaportës së Republikës së Kosovës ,ndërsa për shtetasit e huaj , kopja e letërnjoftimit për të huaj,me leje qëndrimi mbi 6 muaj;
  - Me rastin e aplikimit ,personi dorëzon patentë shoferin origjinal dhe duhet të prezantojë origjinalin e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës.
- 
- Certifikatën shëndetësore të vlefshme për patentë shoferë për kategoritë profesionale. ( A1. A. C1. C. CE. D1. D. DE), si dhe për të gjithë kandidatët më të vjetër se 65 vite edhe për kategorinë B,BE.
    - Fletëpagesa në vlerë prej 15€